

# Vaksinimet kundër koronavirusit në Turku

Vaksinimet kundër koronavirusit kanë filluar në Turku. Vaksinimet janë vullnetare dhe falas për banorët me banim të përhershëm në Finlandë.

Në Turku vaksinimet kanë filluar te banorët e Turkut më të moshuar mbi 80 vjeçarë. Së pari vaksinohen grupet e të më moshuarve e pastaj vaksinimi vazhdon tërë pranverën kah grupet e moshave më të reja.

Banorët rezervojnë vet kohën për vaksinim ose në shërbimet elektronike të rezervimit të kohës përmes telefonit të koronavaksinimit. Për vaksinim gjithmonë duhet të rezervoni kohën paraprakisht në mënyrë elektronike ose përmes telefonit.

## Të gjitha informacionet për vaksinimet në Turku:

Informacionet më aktuale për grupet që vaksinohen gjinden në internet-faqet e koronavaksinimit të qytetit Turku në finlandishte, në suedishte dhe në anglishte:

- [www.turku.fi/koronarokotus](http://www.turku.fi/koronarokotus)
- [www.turku.fi/sv/coronavaccinationer](http://www.turku.fi/sv/coronavaccinationer)
- [www.turku.fi/en/coronavirusvaccinations](http://www.turku.fi/en/coronavirusvaccinations)

Poashtu, në internet-faqet e qytetit Turku gjindet edhe Åbot-koronainfo, e cila shërben në dhjetë gjuhë të ndryshme.

Në këto faqe gjinden edhe "Pyetjet më të shpeshta"-faqja, në të cilën gjinden përgjigjet në pyetjet më të shpeshta për koronavaksinimin.

## Telefoni i koronavaksinimi në Turku

Telefoni i koronavaksinimit shërben nga he-pr ora 8-14, t. 02 266 0159. Në këtë telefon mund të rezervoni kohën për koronavaksinim apo mund të pyetni për gjërat lidhur me koronavaksinimin.

## Vendi i vaksinimit është në Qendrën e panairëve në Turku

Kur është radha e juaj për vaksinim, rezervoni kohën përmes shërbimit elektronik të rezervimit të kohës ([www.turku.fi/koronarokotus](http://www.turku.fi/koronarokotus)) ose telefononi në telefonin e koronavaksinimit.

Vaksinat ipen në Qendrën e panairove në Turku (adresa: Messukentänkatu 9–13). Aty mund të vini **me autobus ose me makinën e juaj**. Për ata që vijnë me makinë ka mjaftë vende parkingu falas në kuadër të Qendrës së panairove. Autobusi nro 100 qarkullon nga qendra e Turkut deri në Qendrën e panairove nga dita e hënë deri të premtën.

## Çfarë duhet marrë parasyshë kur të mbërrini në Qendrën e panairove?

- Ejani pa simptome të koronës
- Mbajeni distancën dhe higjienën e duarve
- Përdorni maskën mbrojtëse në mbërritje dhe në Qendrën e panairove
- **1. personi që bën pjesë në grupin medicinal të rrezikuar** duhet të jetë gati që në Qendrën e panairove të dëshmon arsyet se pse bën pjesë në grupin e rrezikuar, për shembull Kela-karta, çertifikata e mjekut ose shenimet në sistemin e të dhënave të pacientëve.
- Ejani me kohë (brenda mund të hyni saktësisht 15 minuta para kohës për vaksinim)
- Merrni me veti Kela-kartën
- Vishni këmbishën që zhvishet lehtë
- Pas vaksinimit duhet të pritni aty në vendin e vaksinimit edhe rreth 15 minuta

## Informacione tjera për vaksinën kundër koronavirusit:

<https://thl.fi/en/web/infectious-diseases-and-vaccinations/what-s-new/coronavirus-covid-19-latest-updates/transmission-and-protection-coronavirus/vaccines-and-coronavirus>